

VENDIM
Nr. 484, datë 14.10.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E DHËNIES
DHE RINOVIMIT TË LICENCEVE PROFESIONALE PËR SUBJEKTET
JURIDIKE E FIZIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA”**

Në zbatim të neneve 10, dhe 14 dhe 19, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke qenë se riorganizimi i shoqërive UK në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP-UK), sjell ulje të numrit të shoqërive aktuale njëkohësisht dhe uljen e të ardhurave në buxhetin e ERRU-së, si dhe duke pasur parasysh periudhën kalimtare të transferimit të tyre në SKP-UK:

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 5, të vendimit nr. 29, datë 8.12.2009, i Komisionit Kombëtar Rregullator “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, pas fjalëve të titullit, sipas kategorive të përcaktuara me VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009... shtohet “për shoqëritë UK që ende nuk janë riorganizuar sipas VKM nr. 302, datë 11.5.2022”.

2. Pas aneksit nr. 5, të vendimit nr. 29 datë, 8.12.2009, të Komisionit Kombëtar Rregullator “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, shtohet aneksi me nr. 5/1 me titull “Sipas kategorive të përcaktuara me VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009 për shoqëritë të riorganizuar sipas VKM nr. 302, datë 11.5.2022.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK, shoqëritë subjekte me Kompetenca të Përbashkëta Ujësjellës-Kanalizime, si dhe të gjitha strukturat e ERRU-së.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

ANEKSI 5/1
PAGESAT PËR LICENCIM

1. Sipas kategorive të përcaktuara në vendim nr. 958, datë 6.5.2009, për shoqëritë të riorganizuar sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022.

POPULLSIA E ZONËS SË MBULIMIT	PAGESAT			
	Kategoria A, grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik	Kategoria B, për përpunimin e ujit për konsum publik	Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura	Kategoria D, për përpunimin e ujërave të ndotura
50.000 - 100.000 banorë	60,000	60,000	60,000	60,000
100.000 - 150.000 banorë	80,000	80,000	80,000	80,000
150.000 - 200.000 banorë	120,000	120,000	120,000	120,000
200.000 – 500.000 banorë	150.000	150.000	150.000	150.000
Mbi 500.000 banorë	170.000	170.000	170.000	170.000

Ndryshim drejtuesi ligjor	40.000
Ndryshim drejtuesi teknik	40.000

Shënim. Operatorët do të bëjnë pagesat sipas tabelës së mësipërme në rast ndryshimi të kategorisë së shërbimit, të popullsisë në zonën e shërbimit apo ndryshim drejtuesi ligjor dhe/ose teknik.